



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 18 prill 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Mufera Şinik Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hasan Preteni – drejtor i AKK-së, Bedri – AKK, Shefki Kastrati – NDI, Petrit Hysaj – OSBE, Shahadije Bikliqi – KTV, Faton Salihu – RTK, Valentina Rafuna – Rrokum - TV, Mejreme Tahirukaj – RTK - Radio, Bujar Ireni – RTV 21, Isuf Zejna – KDI, Lumnije Murati – ZPRK dhe Fixhrije Dragaj - praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28. 3. 2011;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2010;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L -010 për noterinë;
4. Shqyrtimi i draftregullave për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika katërt të shqyrtohet para pikës së tretë, ndërsa pika pestë të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28. 3. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 28. 3. 2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2010

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit dhe drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që e ftoi z. Preteni ta paraqesë Raportin e kësaj Agjencie.

Hasan Preteni - drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit - E njoftoi Komisionin për aktivitetin dhe për pengesat në punën e Agjencisë. Shprehu mendimin se Agjencia posedon burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, si dhe në aspektin e infrastrukturës fizike e ka hapësirën e mjaftueshme për realizimin e detyrave ligjore. Ai theksoi se me gjithë përmirësimet, pengesë kryesore në punën e saj janë infrastruktura ligjore, veprimet joefektive të institucioneve të autorizuara, me të cilat bashkëvepron Agjencia për parandalimin, hetimin dhe për luftimin e veprave të korrupsionit. Ai paraqiti shifra për punën e institucionit, që ai udhëheq, gjatë vitit 2010. Vuri në pah se është vërejtur shtim i besimit të qytetarëve tek Agjencia Kundër Korrupsionit me 430 raste të kontaktuara nëpërmjet formave të ndryshme, në bazë të të cilave Agjencia ka gjetur bazën për fillimin e hetimeve paraprake në 139 raste, nga të cilat 29 kanë përfunduar në prokurori.

Ibrahim Makolli - Iu referua faqes 10 të Raportit. A është obligim i Agjencisë të nxjerrë përfundime t'i vlerësojë si vepra penale apo është obligim i organeve të gjyqësisë? Lidhur me këtë konsideroj se autoritet për ta vlerësuar një veprim si vepër penale është gjykata, kurse në këtë pjesë të Raportit thuhet "nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore është vepër penale". A janë dyshime këto, apo gjykata pas vlerësimit të provave të paraqitura nga ana juaj ka vërtetuar se këto raste janë të sakta?

Armend Zemaj – E vlerësoi Raportin. Shtoi se ajo që ka qenë dhe është brengosëse, e që edhe përmes ligjit jemi munduar ta përfshijmë është çështja e prejardhjes dhe e deklarimit të pasurisë së zyrtareve të lartë publikë. Tha se është e rëndësime që Agjencia ta bëjë identifikimin e prejardhjes së pasurisë, sidomos të zyrtarëve të lartë publikë. Në vazhdim e përmendi bashkëpunimin e Agjencisë me institucionet e caktuara, që shpesh ngurrojnë të bashkëpunojnë. Pyeti: Sa është arritur progres në bashkëpunim me policinë, sidomos për krime ekonomike dhe me prokuroritë? Shprehu shqetësimin se as në këtë Raport dhe as në raportet e mëparshme nuk përmenden çështjet që kanë të bëjnë me presionet e caktuara që i bëhen Agjencisë që të mos e kryejë punën ashtu siç duhet.

Behar Selimi – E falënderoi z. Preteni për punën e tij për këto vite. Shtoi se përkundër asaj që Agjencia nuk ka shumë autorizime në këtë rrafsh, ka bërë punë të mirë, duke i vënë në lëvizje edhe institucionet e caktuara ekzekutive. Ceku se rekomandimet e paraqitura nga Agjencia, Komisioni duhet t'i ketë parasysh, sidomos të jetë prioritet i Komisionit amendamentimi i kodit penal në mënyrë që të parashihen veprat e caktuara penale, që mund të jenë mbështetje për punën e Agjencisë. Në veçanti e përmendi ligjin antimafi, sepse nxjerrja e këtij ligji është me rëndësi për vendin, siç është edhe rishikimi i Ligjit për prokurimin publik. A ka ndërhyrje në punën e Agjencisë nga faktori vendor, si dhe nga faktori ndërkombëtar?

Albulena Haxhiu - Tha se Agjencia duhet të jetë më efikase në luftën kundër korrupsionit. Duke iu referuar Raportit vuri në pah se në faqet 16 dhe 17 të Raportit është një dallim i madh midis numrit të rasteve të proceduara dhe të rasteve të zgjidhura. Pra shihet një problem midis AKK-së dhe institucioneve, me të cilat ajo bashkëpunon. Ishte e mendimit se Agjencia duhet të mbështetet në realizimin e punës së saj dhe se është i nevojshëm ndryshimi i legjislationit. Çka përfiton AKK-ja nga nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit? A janë të mjaftueshme dhe a kanë elemente detyruese ndaj institucioneve nënshkruese?

Ardian Gjini - Tha se AKK-ja nuk është i vetmi institucion që merret me luftimin e korrupsionit. Nëse thuhet sa ka korrupsion nuk mund të themi se Agjencia nuk e ka kryer punën e saj. Ishte i mendimit se Agjencia më tepër duhet të fokusohet në ndërtimin e barrierave strukturore në luftimin e korrupsionit, e jo të fokusohet shumë në barrierat subjektive, si deklarimi i pasurisë së individëve të caktuar. Shtoi se duhet të rriten kapacitetet e Agjencisë edhe në ndërtimin e sistemit legjislativ dhe në atë institucional, që sa më shumë të pamundësohet korrupsionin në Kosovë. Do të ishte mirë që për secilin ligj, që kalon në Kuvend, të pyetet edhe të Agjencia se a mendon që me anë të atij ligji do të krijohen kushte për korrupsion ose do të reduktohet mundësia për korrupsion.

Haki Demolli - E përgëzoi drejtorin e AKK-së për punën e mirë në hartim të këtij Raporti. Theksoi se brenda të dhënave për vitin 2010 Agjencia i ka pranuar 430 informata, prej të cilave 139 janë hetuar dhe 29 janë proceduar në prokuroritë kompetente, që do të thotë se diku 6% e tyre janë proceduar. Dyshon se a është e mjaftueshme kjo përqindje për punën Agjencisë brenda një viti. Ishte i mendimit se për të pasur më të qartë këtë përqindje, në të ardhmen do të ishte mirë që me një fusnotë të shtohet edhe numri i rasteve të paraqitura në prokurori, në mënyrë që të jetë e mundur të bëhen krahasime se sa ka qenë kontributi i Agjencisë në paraqitjen e këtyre rasteve. Duke iu referuar faqeve 16 dhe 17 të Raportit tha se ka një mospërputhje, që ndoshta është lëshim teknik. Pyeti: Pse nuk ka informata kthyesë, dhe ku qëndron problemi lidhur me rastet e paraqitura nga Agjencia? Po ashtu theksoi se vitin e kaluar drejtori i AKK-së në takimin me prokurorin e shtetit, me kryetarin e Gjykatës Supreme, me ministrin e Drejtësisë, janë pajtuar që të t'u jepet prioritet rasteve të paraqitura nga Agjencia. Pyeti: A e ka bërë ndonjë hetim AKK-ja lidhur me prejardhjen e pasurisë dhe cilat janë vështirësitë?

Arsim Bajrami - Theksoi se Raporti është gjithëpërfshirës dhe përmban të dhëna konkrete. Po ashtu shihet se Agjencia i ka realizuar dy funksionet themelore: hetimin e rasteve dhe funksionin preventiv, duke i dhënë edhe rekomandimet adekuate. Dobësia që po e përcjell Kosovën është çështja e prokurimit publik, që flet se duhet të bëhen ndryshime në ligjet që e mbulojnë këtë sferë, sipas praktikave më të mira të shteteve të tjera. Zgjidhja afatgjatë e këtyre është transparenca e plotë e prokurimit publik, veçmas ajo e prokurimeve elektronike. Theksoi se i mbështet rekomandimet e dhëna, veçmas atë pjesë që e adreson nevojën e ndryshimit të legjislacionit.

Halit Krasniqi - E përgëzoi drejtorin e Agjencisë për punën e bërë. Shtpoi se Agjencia vlerësohet nga qytetarët për punën dhe për besueshmërisë. Duke iu referuar Raportit foli rreth numrit të kallëzimeve penale, nga të cilat 201 lëndë janë dërguar në prokuritë kompetente kanë rezultuar me 61 të hedhura, kurse për 43 nuk ka informata kthyesë. Nëse Agjencia vlerëson se duhet t'i rriten kompetencat duhet ta kërkojë mbështetjen e Komisionit që të realizojë funksionalizimin e saj.

Arben Gashi - I paraqiti vërejtjet në Raport, si nga aspekti strukturor dhe organizativ. Pjesa e parë e Raportit është e panevojshme. Ndoshta kjo pjesë mund të ishte aneks i Raportit, por jo pjesë hyrëse, ku është bëhet fjalë si është e organizuar Agjencia. Raportit i mungojnë të dhënat konkrete, për të cilat mund të operonim, kurse të dhënat e paraqitura janë shumë të përgjithësuara. Do të duhej të kualifikoheshin veprat e përbashkëta ose keqpërdorimet e përbashkëta, në mënyrë që të adresoheshin si rekomandime për Komisionin. Në këtë fokus Agjencia është dashur të japë rekomandime për veprat korruptive me karakter të përbashkët si mund të marrë masa komisioni në këtë drejtim. Në vazhdim foli për rastet e proceduara në prokuroritë kompetente nga Agjencia, për të cilat ka mospërputhje shumë të madhe dhe mungojnë edhe të dhënat se sa prej rasteve janë vendosur në favor të asaj që ka kërkuar Agjencia. Në bazë të këtij Raporti shihet se Agjencia ka pasur suksesi më të madh në deklarimin e pasurisë dhe në gjobat e shqiptuara për individët për mosdeklarim të pasurisë, për akomodimin e Agjencisë dhe për zgjidhjen e çështjeve buxhetore.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigj drejtori i Agjencisë, Hasan Preteni, që ndër tjera sqaroi se pyetja e deputetit Haki Demolli është me vend, ngase numri 88 në faqen 16 të Raportit është lëshim teknik dhe duhet të jetë 43.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2010.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L -010 për noterinë

Komisioni vlerësoi se Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 010 për noterinë, në aspektin përmbajtjesor, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë*

R e k o m a n d i m

- 1. Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për noterinë nr.03//L – 010.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi